



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primjen/Prodato Received/Delivery	20. 05. 2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	2574/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.258/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 05.04.2021 me numër A.nr.258/2021, e parashtruar përmes postës së Kosovës me numër R1537258, e regjistruar në KPMSHCK me datë 08.04.2021, nga ankuesja

ne adresë: Rr. "Qamil Olluri", Nr.3-hymja I, Komuna e Lipjanit, kundër Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.258/2021 e datës 08.04.2021 e parashtruar nga ankuesja

II.MBETET në fuqi Vendimi me Nr.1-112-10125 i datës 19.02.2021, i Kryetarit të Komunës së Lipjanit, për kthim në vendin e punës ankuesen me të gjitha të drejtat dhe obligimet e caktuara në këtë vendim, duke i bërë kompensimin e shumës së ndalur- 50% të pagës respektivisht përmbushjen e detyrimit sipas pikës II të këtij vendimi duke përfshi periudhën nga data 15.02.2017 deri më 01/03/2021.

III.OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Lipjanit që të bëjë zbatimin e pikës II të vendimit Nr.1-112-10125 të datës 19.02.2021 brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Lipjanit në vendin e punës: "Udhëheqëse e Sektorit për Kadastër", në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, sipas Akt emërimit Nr.1-111-63819 të datës 18.11.16,e cila me Vendimin Nr.1-116-6248 të datës15.02.2017 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, ka qenë e pezulluar nga puna si masë parandaluese, me pagesë 50% të pagës për arsye se i ishte ngritur aktakuzë me numër PPS.Nr.75/2015 të datës 13/02/2017.

Me datë 26.01.2021 ankuesja mbi bazë të Aktgjykimit APS.nr.33/2010 të Gjykatës së Apelit-Departamentit Special ka parashtruar kërkesë me nr.1-116-5568 zyrës së personelit për kthim në vendin e punës.

Me datë 19.02.2021 Kryetari i Komunës së Lipjanit, duke u bazuar në Aktgjykimin APS.nr.33/2010 të Gjykatës së Apelit-Departamentit Special të plotfuqishëm më datë 15/12/2020, ka nxjerrë Vendimin me nr.1-112-10125, për kthim në vendin e punës të ankuses nga data 01/03/2021.

Pas kthimit në vendin e punës "Udhëheqëse e Sektorit për Kadastër", në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, ankuesja duke parë se nuk i është bërë kompensimi i 50% të pagave në fund të muajit shkurtë 2021 të konfirmuar sipas listës së pagave me që rast kthehet në punë ankuesja nga data 01/03/2021, respektivisht nuk është zbatuar pika e dytë e vendimit Nr.1-112-10125 i datës 19.02.2021,dhe mbi këtë arsye me datë 26.02.2021, ka parashtruar kërkesë me nr.6-120-11429 tek Drejtoria për Buxhet dhe Financa duke kërkuar zbatimin e pikës II të vendimit Nr.1-112-10125 i datës 19.02.2021 ,për pagesën e 50% të ndaluar sipas vendimit Nr.1-116-6248 të datës 15.02.2017 me rastin e pezullimit parandalues, ndërsa udhëheqësi i sektorit të Buxhetit dhe Financave të komunës së Lipjanit më datë 09.03.2021 i është përgjigje Udhëheqësit të personelit të Komunës së Lipjanit. Lidhur me mos planifikimit buxhetor për vitin 2021-2023 nuk janë paraparë kompensimet e -50% të mjeteve buxhetore për kategorinë e nëpunësve që janë me pezullim parandalues.

Ankuesja për shkak të mos zbatimit e plotë të Vendimit me Nr.1-112-10125, të datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, respektivisht të pikës II të vendimit, me datë 29.03.2021 ka parashtruar ankesë me nr.1-400-1688, drejtuar Komisionit për ankesa në Komunë të Lipjanit, lidhur me kompensimin pagës së ndaluar - 50%,me rastin e ndalesës me rastin e pezullimit parandalues.

Përkundër që sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nuk ka komision të ankesave brenda këtij institucioni por se ankuesja mbi bazë të ankesës së datës 29.03.2021 ka pranuar përgjigjen e datës 31.03.2021 nga Udhëheqësja e personelit të Komunës së Lipjanit, duke e udhëzuar ankuesen se me hyrje të fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, e drejta për ankimim është në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

E pa kënaqur në përgjigjen e datës 31.03.2021, ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 05.04.2021, përmes postës së Kosovës, me numër R1537258, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datë 08.04.2021 në KPMSHCK me numër A.nr.258/2021, me numër protokolli 1669/2021, me pretendimin për zbatim të pikës II të vendimit Nr.1-112-10125, të datës 19.02.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit. Këshilli me datë 17.05.2021 përmes E-mailit, zyrtar ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Lipjanit, me dokumentacionin e bashkangjitur lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesë A.nr.258/2021 e pranuar në Këshill me datë 08.04.2021, me numër protokollit 1669/2021, e parashtruar me datë 08.04.2021 përmes postës së Kosovës R 1537258 në Këshill të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr.1-112-10125 të datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit; Akte emërimi nr.1-111-63819 të datës 18.11.16; Vendimin Nr.1-116-6248 e datës 15.02.2017 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit; Kërkesë nr.1-116-5568 e datës 26.01.2021; Nr.1-116-5568; Kërkesë Nr.1-120-11429 e datës 26.02.2021; Ankesë nr.1-400-16888 e datës 29.03.2021 në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa; Përgjigje e datës 31.03.2021 në kërkesën Nr.1-400-16888; Përgjigje në ankesë E-maili i datës 17.05.2021, me numër protokollit 1-23760 të datës 14.05.2021; Aktgjykimin APS.nr.33/2010 të Gjykatës së Apelit-Departamentit Special; Kërkesë nr.1/12-21890 e datës 29.04.2021; Formulari i të dhënave personale për listën e pagave e datës 01.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje në mënyrë meritorë ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses

është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesja me datë 05.04.2021 ka parashtruar ankesë përmes postës së Kosovës me numër R1537258, e pranuar me datë 08.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër A.nr.258/2021 e protokolluar me numër 1669/2021, me pretendime ankimore për mos zbatimin e Vendimit me nr.1-112-10125 të datës 19.02.2021, të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, respektivisht pikën II të vendimit, pasi që ankuesja e ka pranuar përgjigjen e datës 31.03.2021 nga Udhëheqësja e personelit të Komunës së Lipjanit, për ankesën nr.1-400-16888 të datës 29.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja me Vendimin me Nr.1-116-6248 të datës 15.02.2017, të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, është pezulluar nga puna me 50% të pagës, për shkak se ndaj saj është ngritur aktakuzë me numër PPS.Nr.75/2015 sipas njoftimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 69 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.2, 1.3 paragrafin 2 dhe paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: *'Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj, 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjyqimit; 1.3. kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet. 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. 3. Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të*

tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi", i cili vendim ka qenë në fuqi deri me nxjerrjen e Vendimit me Nr.1-112-10125 të datës 19.02.2021, të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, për kthimin e ankueses në vendin e punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka konstatuar se Aktgjykimi APS.nr.33/2010 i Gjykatës së Apelit-Departamentit Special, me datë 15.12.2020 është bërë i plotfuqishëm dhe ankuesja është liruar nga akuza, ankuesja me datë 26.01.2021 mbi bazë të këtij aktgjykimi të apostrofuuar më lartë ka parashtruar kërkesë tek Zyra e personelit në Komunë të Lipjanit për kthim në vendin e punës: "Udhëheqëse e Sektorit për Kadastër", në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunë të Lipjanit, me të gjitha të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Me datë 19.02.2021 Kryetari i Komunës së Lipjanit mbi bazë të aktgjykimit APS.nr.33/2010,i plotfuqishëm nga data 15/12/2020 të Gjykatës së Apelit-Departamentit Special , ka nxjerrje Vendimin me Nr.1-112-10125 me të cilin ankuesen e kthen në vendin e punës në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit për Kadastër", në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, ndërsa përkundër që nga organi i punësimit në këtë rast komuna e Lipjanit është zbatuar pika e parë e këtij vendimi, por nuk i është bërë kompensimi i shumës së ndalur- 50% të pagës, sipas obligimit ligjor të këtij vendimi sipas pikës II, e cila ndalës i është bërë gjatë kohëzgjatjes së pezullimit nga data 15.02.2017 deri me datë 01.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara me rastin e mos pagesës së pagës së ndalur - 50% të pagës, siç është caktuar në Vendimin e datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, edhe pse ankuesja është kthyer në vendin e punës "Udhëheqëse e Sektorit për Kadastër", në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunë të Lipjanit, nuk i është bërë kompensimi sipas obligimit ligjor të përcaktuara në këtë vendim.

Andaj, duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi", në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar me që rast është obligim i organit të punësimit, që ankueses tij bëjë kompensimin e pagës së ndalur - 50% të pagës nga momenti i pezullimit parandalues sipas Vendimit të datës 15.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit me numër Nr.1-116-6248, duke bërë përmbushjen e detyrimit në pikës II të dispozitivit të Vendimit me nr.1-112-10125 të datës 19.02.2021.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.258/2021, datë 20.05.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Burime Njerëzore të Komunës së Lipjanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.



m